

VENDIM
Nr. 426, datë 15.5.2013

**PËR NGRITJEN, FUNKSIONIMIN DHE DETYRAT E KOMISIONIT KOMBËTAR PËR
NOMENKLATURËN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12/2 të ligjit nr. 9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën, për kryerjen e përditësimit, përshtatjen dhe zbatimin e klasifikimeve zyrtare ekonomike e sociale, në përputhje me nomenklaturat europiane dhe ndërkombëtare.

2. Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën kryesohet nga drejtori i përgjithshëm i Institutit të Statistikave dhe në përbërje ka këta anëtarë:

- a) një përfaqësues nga Banka e Shqipërisë;
- b) një përfaqësues nga Ministria për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit;
- c) një përfaqësues nga Ministria e Financave;
- ç) një përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
- d) një përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
- dh) një përfaqësues nga Ministria e Brendshme;
- e) një përfaqësues nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit;
- ë) një përfaqësues nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
- f) një përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë;
- g) një përfaqësues nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;
- gj) një përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;
- h) një përfaqësues nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë;
- i) një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
- j) një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- k) një përfaqësues nga Qendra Kombëtare e Regjistrimeve;
- l) një përfaqësues nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;
- ll) tre përfaqësues nga INSTAT-i.

3. Përfaqësuesit e institucioneve, anëtarë të Komisionit, caktohen nga titullarët e institucioneve, sipas kritereve dhe kërkesave të paraqitura nga Instituti i Statistikave.

4. Për përgatitjen e mbledhjeve dhe koordinimin e çështjeve të Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën, krijohet sekretariati i Komisionit, me përbërje specialistë të Institutit të Statistikave. Rregullat për funksionimin e sekretariatit përcaktohen me rregulloren e miratuar nga Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën.

5. Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën mblidhet me thirrjen e kryetarit. Mbledhjet e Komisionit zhvillohen sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 8480, datë 25.8.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

6. Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën mund të ngrejë grupe pune, sipas fushave dhe nevojave të tij, me përbërje nga të gjitha institucionet e përfshira në Komision ose një pjesë të tyre. Rregullat për funksionimin e këtyre grupeve dhe shkallën e tyre të përgjegjësisë përcaktohen me vendim të veçantë të këtij Komisioni.

7. Nomenklaturat e miratuara paraprakisht nga Komisioni Kombëtar për Nomenklaturën miratohen me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

8. Vendimi nr. 327, datë 18.7.1994 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e zbatimit të Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike”, i ndryshuar, shfuqizohet.

9. Ngarkohen Instituti i Statistikave dhe institucionet e përmendura në pikën 1 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha